



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dispozitat e nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të propozimit të grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020, të dt. 23.01.2020, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2021, miratoi

PLANIN

VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS

I.

MIRATOHET Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021.

II.

Plani vjetor i cekur në pikën I të këtij vendimi, përmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahet mbledhja e Kuvendit të Komunës dhe pikat - temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Komunës.

III.

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës me përmbajtjen e cekur në pikën II të këtij vendimi, është si në vijim:

1. Muaji janar:

- Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2019;
- Informatë nga Drejtoria e Parqeve mbi menaxhimin e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në komunën e Prishtinës;
- Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-464/01-263767/18, dt. 01.11.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
- Propozimvendimimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë;

- Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme, për vitin 2021;
- Propozimvendimi për formimin e komisionit për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021;
- Diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Termokos", SHA Prishtinë;
- Propozimrregullorja e punës së Këshillit drejtues të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona";
- Propozimrregullorja për caktimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim për më pak se një vit;
- Propozimvendimi për subvencionimin e çerdheve me bazë në komunitet.

2. Muaji shkurt:

- Propozimplani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021;
- Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2020 (TM 4);
- Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2020;
- Informatë rreth raportit për vlerësimin e performancës së Komunës (nga Drejtoria e Administratës);
- Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2020/2021;
- Propozimet për këmbimin e pronave komunale me prona në pronësi të personave fizikë;
- Seancë solemne me rastin e përvjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës;
- Shqyrtimi i raportit (informatës) për aktivitetet e KKSB-së.

3. Muaji mars:

- Raporti vjetor për çështje ekonomiko-financiare për vitin 2020;
- Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit zhvillimor të komunës së Prishtinës;
- Raportet vjetore të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës;
- Bartja e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2020 në vitin 2021;
- Informatë për punën e Drejtorisë së Inspeksionit;
- Propozimet për këmbimin e pronave komunale me prona në pronësi të personave fizikë;
- Informatë rreth raporteve të punës së Drejtorisë së Pronës.

4. Muaji prill:

- Shqyrtimi i informatës financiare (TM 1) të Komunës, për periudhën janar - mars 2021 (TM 1);
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave të tjera nga ekzekutivi komunal;
- Propozimet për këmbimin e pronave komunale me prona në pronësi të personave fizikë;
- Informatë rreth mbjelljeve pranverore në komunën e Prishtinës;
- Raportet e komisioneve komunale të aksionareve të NP-ve .

5. Muaji maj:

- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Hartës zonale të komunës së Prishtinës;
- Informatë për ndarjen e bursave për studentë;
- Informatë për gjendjen e sportit në komunën e Prishtinës (Drejtoria e Sportit);
- Informatë për gjendjen e kulturës në komunën e Prishtinës;
- Informatë mbi qarkoren e parë buxhetore të brendshme komunale;
- Propozimet për këmbimin e pronave komunale me prona në pronësi të personave fizikë.

6. Muaji qershor:

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2021;
- Seancë solemne 11 Qershori - Dita e Çlirimit të Prishtinës;
- Informatë për rendin dhe qetësinë në komunë (Policia e Kosovës);
- Informatë rreth menaxhimit dhe përkujdesjes së mirëmbajtjes së kushteve për qentë endacakë;
- Korniza afatmesme buxhetore 2022-2024;
- Informatë rreth gjendjes së furnizimit me ujë (Kompania e ujësjellësit rajonal "Prishtina", SHA);
- Propozimet për këmbimin e pronave komunale me prona në pronësi të personave fizikë.

7. Muaji korrik:

- Raport i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021;
- Shqyrtimi i Informatës financiare të Komunës, për periudhën prill – qershor 2021 (TM2);

- Informatë për raportin e Zyrës së Auditortit të Përgjithshëm për vitin 2020;
- Informatë mbi qarkoren e dytë buxhetore të brendshme komunale;
- Informatë për performancën e Komunës, MAPL;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për realizimin e planit vjetor të Prokurimit Publik, 2021.

8. Muaji gusht: Pushim

9. Muaji shtator:

- Propozimbuxheti për vitin 2022;
- Informatë për mbarimin e vitit shkollor 2020/2021 dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2021-2022;
- Shqyrtimi i projektregullores për tatim në pronë;
- Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të vitit shkollor 2020/2021, testit të arritshmërisë dhe testit të maturës;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë rreth Planit zhvillimor komunal të Prishtinës;
- Informatë rreth ofrimit të ndihmave me artikuj të ndryshëm për familjet me gjendje të rëndë sociale;
- Informatë për gjendjen e pyjeve në komunën e Prishtinës;
- Informatë nga drejtoria për të mbjellat vjeshtore dhe korrje-shirjet.

10. Muaji tetor:

- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën korrik - shtator 2021 (TM3);
- Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi, sasia e sipërfaqeve dhe lloji i kulturave të mbjella;
- Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për gjendjen në institucionet shëndetësore (QKMF, QMU, QMF etj.);
- Informatë rreth shtrirjes dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës në komunën e Prishtinës;
- Propozimet për këmbimin e pronave komunale me prona në pronësi të personave fizikë.

11. Muaji nëntor:

- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve për sezonin dimëror;
- Informatë mbi sigurinë në komunën e Prishtinës (Policia e Kosovës);

- Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës;
- Seancë solemne me rastin e festës së 28 Nëntorit.

12. Muaji dhjetor:

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;
- Shqyrtimi i propozimvendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal;
- Informatë rreth organizimit të festave të fundvitit nga Komuna e Prishtinës;
- Informatë për punën e komiteteve.

IV.

Për zbatimin e pikës III të këtij vendimi do të kujdesen: kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive, drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe arsimore dhe Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjet publike lokale.

V.

Ky plan hyn në fuqi 15 ditë nga dita e protokollimit në Njësinë për administrimin e dokumenteve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-27303/21, më 11.02.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë vetëqeverisjen lokale, dhe Statutit të Komunës së Prishtinës.

Sipas LVL-së, Kuvendi i Komunës nuk e delegon përgjegjësinë e tij lidhur me marrjen e Vendimit për planin vjetor të punës së tij (neni 40, paragrafi 40.1, pika d).

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 08.01.2021, ka themeluar Grupin punues për hartimin e propozimplanit të Kuvendit të Komunës për vitin 2021.

Grupi punues ka mbajtur takim, më 25.01.2021, dhe pas finalizimit të këtij propozimplani, i njëjti i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtimin dhe miratimin e tij.